



Lajmet e Fundit:

Tiranë – Vihen në pranga 9 shtetas, 2 prej tyre të shpallur në kërkim, dhe procedohen penalisht 4 të tjerë, për vepra të ndryshme penale



14/01/2022

Tiranë – Sekuestrohen armë zjarri dhe sende të kundërligjshme, në pranga poseduesi

Tiranë/Kontrolle të shtuara për kapjen e personave që qarkullojnë me armë zjarri apo i mbajnë ato pa leje në banesë.

Si rezultat i kontrolleve, nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4 është goditur një rast i armëmbatjes pa leje.

Vihet në pranga një 23-vjeçar që posedonte një armë zjarri pistoletë dhe fishekë luftarak.

Sekuestrohen një armë zjarri pistoletë, municion luftarak, një pistoletë zhurmuese, maskë, thikë e sende të tjera të kundërligjshme.

Në zbatim të planit të masave për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, si rezultat i kontrolleve të shtuara nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4, bazuar edhe në informacionet e marra në rrugë operative, u arrestua në flagrancë shtetasi M. G., 23 vjeç, banues në Tiranë.

Pas lokalizimit dhe ndalimit të mjetit me të cilin po qarkullonte ky shtetas, shërbimet e Policisë kanë ushtruar kontroll në mjet dhe kontroll fizik nga drejtuesit, të cilit i kanë gjetur një sasi fishekësh. Në vijim të kontrollit, në banesën e tij, Policia gjeti një armë zjarri pistoletë, fishekë luftarak, një pistoletë zhurmuese, fishekë zhurmues, një thikë, një shkop bejzbolli, një kuti metalike me një sasi saçmash për armë sportive dhe një maskë, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, së bashku me automjetin me të cilin udhëtonte 23-vjeçari.

Metarialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)



Share



Share



Share



Share



Email

◀ Dibër/Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar “Evazioni”

Kukës – Kapet dhe ndalohejt një shtetas i shpallur në kërkim në kuadër të operacionit policor të koduar “Vila” ▶